



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

DH.Shk II.nr.1703/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “Raiffesien Bank Kosovë” (RBKO) Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Robert Doll”, nr. 99, kundër debitorëve: 1 “Buka prej Guri” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810316085 dhe seli në Klinë ; 2 L.G. me numër personal dhe adresë në Sferkë, Komuna e Klinës ; 3 Q.G. me numër personal ... dhe adresë në Sferkë, Komuna e Klinës ; 4 “NNSH Buka prej Guri” me numër të biznesit 70512572, dhe seli në Sferkë, Klinë; 5 “Buka prej Guri LMG” Sh.P.K, me numër unik identifikues 810188004, dhe seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2427/22 të datës 30.10.2023, me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Raiffesien Bank Kosovë” (RBKO) Sh.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2427/22 të datës 30.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.2427/22 të datës 30.10.2023, ne dispozitiv të aktvendimit ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorëve “Buka prej Guri LMG” Sh.P.K, me numër unik identifikues 810188004 dhe L.G. nga Klina, ndërsa ka anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 68/2022, i lejuar me datë 02.03.2022, nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjës faktike si dhe për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të ligjit për procedurën përbarimore, duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anulohet vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2427/22 të datës 30.10.2023, dhe të bëjë vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë, ose të ndryshohet aktvendimi i ankimuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitë debitori dhe ka propozuar që ankesa e kreditorit të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e Marrëveshjes mbi pengun e datës 27.06.2019 për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja e kredisë nr. 200720897 e datës 27.06.2019, e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut me numër të konfirmimit mbi regjistrim R-20190701-220, të datës 01.07.2019, ka lejuar Urdhrin Përbarimor P.nr 68/2022, të datës 02.03.2022, ndaj debitorëve për pagesën e borxhit në lartësi prej 52,854.93 me kamatë të rregullt dhe kamatëvonesë, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitorët “Buka prej Guri LMG” Sh.P.K., dhe L.G., brenda afatit ligjor kanë paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor, me arsyetim se urdhri është lejuar në kundërshtim me gjendjen reale dhe faktike ngase kredia sipas marrëveshjes së datës 27.06.2019 është marr nga debitori “Buka prej Guri” Sh.P.K., dhe se palët janë marr vesh që kredia prej EUR 60,000.00 dhe kredit kartela prej EUR 1,000.00 janë detyrim për pagesë vetëm nga debitori “Buka prej Guri” Sh.P.K. Ndërsa, ka shtuar se kontrata është nënshkruar pa dijeninë e debitorëve në prapësim dhe se ky borxh nuk ju takon atyre ngase nuk kanë qenë në dije se të njëjtit janë përfshirë si kredimarrës apo bashkëredimarrës në kontratën e kredisë. Për këto arsye, gjykatës i kanë propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe se nuk gjen mbështetje në nenin 71 të LPP-së, ndërsa ka shtuar se propozimi për përmbarim i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 38 të LPP-së dhe se organi përmbarues ka lejuar urdhrin mbi bazën e nenit 22, pika 1.7 a të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për procedurën përmbarimore. Ka shtuar se pretendimet e debitorëve se nuk kanë qenë në dijeni se janë të përfshirë në kontratën e kredisë janë të pabazuara ngase debitori “Buka prej Guri LMG” Sh.P.K., është nënshkruese e kontratës në cilësi të bashkëkredimarrësit ndërsa L.G. në cilësi të garantuesit. Në fund, ka theksuar se prapësimi i debitorëve është paraqitur jashtë afatit. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorëve ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2427/22 të datës 30.10.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorëve “Buka prej Guri LMG” Sh.P.K, me numër unik identifikues 810188004 dhe L.G. nga Klina, ndërsa ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 68/2022, i lejuar me datë 02.03.2022, nga Përmbaruesi Privat Blerim Baloku.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se Marrëveshja mbi pengun dhe gjeti se e njejta nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarues në kuptim të nenit 5, paragrafi 2, të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore në raport me debitorët “Buka prej Guri LMG” Sh.P.K., dhe L.G. Kjo për arsye se nga Konfirmimi i regjistrimit të pengut me numër R-20190701-220, debitorët “Buka prej Guri LMG” Sh.P.K., dhe L.G. nuk rezulton të jenë të listuar si penglënës, përkatësisht llogaritë bankare në emër të debitorëve të treguara në Marrëveshjen mbi pengun nuk janë të regjistruara si peng pranë regjistrimit zyrtar të pengut, ashtu siç kërkohet me nenin 5, paragrafi 2, të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore. Krejt në fund ka cek se në konfirmimin mbi regjistrimin e pengut me numër R-20190701-220 të datës 01.07.2019

debitorët nuk janë të indentifikuar si penlënës sipas Marrëveshjes mbi pengun dhe asnjë pasuri e luajshme e debitorëve “Buka prej Guri LMG” Sh.p.k dhe L.G. nuk është e regjistruar si peng.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se Marrëveshja mbi pengun nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarues ashtu si që parashihet me nenin 5 par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, pasi që debitorët nuk janë të listuar si penglënës dhe asnjë pasuri e tyre nuk është e regjistruar si peng, sepse me shiqim të konfirmimit të regjistrimit të pengut R-20190701-220, debitorët “Buka prej Guri LMG” Sh.P.K., dhe L.G. nuk rezulton të jenë të listuar si penglënës, përkatësisht llogaritë bankare në emër të debitorëve të treguara në Marrëveshjen mbi pengun nuk janë të regjistruara si peng pranë regjistrimit zyrtar të pengut, ashtu siç kërkohet me nenin 5, paragrafi 2, të ligjit të lartë cekur. Krejt në fund edhe kjo gjykatë vlerëson se në konfirmimin mbi regjistrimin e pengut me numër R-20190701-220 të datës 01.07.2019 debitorët nuk janë të indentifikuar si penglënës sipas Marrëveshjes mbi pengun dhe asnjë pasuri e luajshme e debitorëve “Buka prej Guri LMG” Sh.p.k dhe L.G. nuk është e regjistruar si peng.

Dhoma e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore të kreditorit, por me shikim të të konfirmimit për regjistrimin e pengut me nr.R-20190701-220 datës 01.07.2019 nuk rezultojnë të jenë të listuar si penglënës debitorët “Buka prej Guri LMG” Sh.p.k dhe L.G. dhe se asnjë pasuri e luajshme e tyre nuk është e regjistruar si peng, por figuron vetëm “Buka prej Guri” Sh.p.k, e për më tepër ky konfirmim nuk e përmbanë përshkrimin e listës së lënë peng të datës 25.06.2019,

poashtu në listën e lënë peng të datës 25.06.2019 nuk përmbanë përshkrime detale lidhur sendet e luajshme, andaj një pretendim të tillë i refuzoj si të pa bazuar, po ashtu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjta mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi ti refuzojë ndërsa aktvendimin e ankimuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përmbaremore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbaremor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbareues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbaremin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1703/23 me datë 22.04.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri